

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2006

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2006, si dhe me Raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni, konstaton se:

- veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e nenit 164 të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndryshuar me ligjin nr.9499, datë 3.4.2006;

- Autoriteti i Konkurrencës ka luajtur një rol të rëndësishëm në nxitjen dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe të interesave të konsumatorëve.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për:

- rritjen e pavarësisë së institucionit dhe të rolit të tij për sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg;

- hartimin dhe miratimin e politikës kombëtare të konkurrencës, të akteve nënligjore e rregulloreve, mbështetur në përvojën e vendeve të rajonit, parimet e BE-së, detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe veçoritë e zhvillimit të konkurrencës e infrastrukturës ligjore në vendin tonë;

- ndjekjen e deformimeve të konkurrencës në treg, marrjen e vendimeve dhe dhënien e rekomandimeve për subjektet që e kanë cenuar atë, si dhe rivendosjen e konkurrencës në tregjet e cenuara;

- hetimin e thelluar ndaj rasteve të abuzimit potencial të subjekteve me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme, fillimin e procedurave të hetimit paraprak në tregun e sigurimeve dhe monitorimin e përqendrimeve në tregun bankar;

- vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe entet rregullatore, si dhe me rrjetin rajonal të autoriteteve të konkurrencës;

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2007 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- përmirësimin e punës organizative dhe institucionale për evidentimin dhe ndalimin e abuzimit të subjekteve me pozitën dominuese në treg, marrëveshjeve të ndaluara dhe bashkimeve ose përqendrimeve të ndërmarrjeve që pengojnë konkurrencën e lirë;

- ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për Ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për kufizimin e konkurrencës së pandershme në sektorë të veçantë të tregut;

- plotësimin e kuadrit ligjor të veprimtarisë së institucionit, me synim përputhjen e tij me legjislacionin e vendeve të Bashkimit Europian dhe detyrimet në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, zgjerimin e bashkëpunimit me Këshillin e Ministrave dhe me Kuvendin për përmirësimin e legjislacionit;

- përmirësimin e punës për informimin e biznesit dhe të të gjithë opinionit publik për njohjen e akteve ligjore e nënligjore në fushën e konkurrencës, duke rritur bashkëpunimin me subjektet që ushtrojnë veprimtari në treg dhe duke e konsideruar median si një faktor të rëndësishëm për përçimin në publik të politikave të konkurrencës;

- rritjen e bashkëpunimit me entet rregullatore, si dhe me strukturat e konkurrencës në vende të tjera të rajonit e të Bashkimit Europian.

19 prill 2007